VENDIM
Nr. 481, datë 1.8.2023

PËR NJË SHTESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2023, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12 e 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve organikë të grupit nr. 87, "Institucione të tjera qeveritare", për vitin 2023, shtohet me 10 (dhjetë) veta, për Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve dhe numri i përgjithshëm i këtij grupi bëhet 1 455 punonjës.

2. Numri rezervë i punonjësve për vitin 2023 reduktohet me 10 (dhjetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjës.

3. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për grupin nr. 87, "Institucione të tjera qeveritare", në programin "Shërbime të tjera" shtohet fondi 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve, përkatësisht fondi 8 000 000 (tetë milionë) lekë në zërin "Shpenzime korrente" dhe fondi 4 000 000 (katër milionë) lekë në zërin "Shpenzime kapitale".

4. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për grupin nr. 87 "Institucione të tjera qeveritare", në programin "Shërbime të tjera", në zërin "Transferta korrente të brendshme", shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh.

5. Efekti financiar prej 62 000 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë) lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama